

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2021*

**03.04.2021
Ora 10:53**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për pranimin për shqyrtim të Kërkesës Ankimore nr.11 me objekt “Kundërshtim i vendimit nr 193, dt.31.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, subjekti ankues PDIU”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** S’ka

Z. K. Bele: Çelim seancën e KAS-it i cili mbledhet për të shqyrtuar në seancë paraprake Kërkesën Ankimore nr.11, të depozituar nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet. Objekti i kundërshtimit është vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.193 dt.31.03.2021 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”. Relator i kësaj çështje jam zgjedhur unë, Koli Bele sipas shortit të hedhur dje në dt.02 Prill 2021, bazuar në nenin 129 të Kodit Zgjedhor. Të pranishëm në seancë janë anëtarët e KAS-it, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së dhe përfaqësues nga administrata e KQZ-së.

Pala ankuese është njoftuar?

*Zbardhi materialin nga shënimet
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.03.04.2021*

Z. Y. Merkaj: Po është njoftuar dhe është shprehur që nuk vjen në këtë seancë.

Z. K. Bele: Ftojme Sekretarin e Përgjithshëm të na relatojë në lidhje me kriteret formale të ankimit!

Z. Y. Merkaj: Atëherë, kërkesa ankimore, ankimon Vendimin nr.193 datë 31.03.2021 “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të votave, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”, të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet. Në këtë vendim Komisioneri ka vendosur që anëtari i tretë dhe i katërt të jetë përkatësisht nga PS dhe LSI. Subjekti ankues PDIU nuk është dakord me këtë vendim dhe e ankimoi tek KAS. Kjo kërkesë është paraqitur në datën 02.04.2021, domethënë elementet e afateve ligjore i përmbush. I është drejtuar KAS-it që është komisioni kompetent për shqyrtimin e kërkesës dhe legjitimimi i ankuesit legjitimohet pasi ka interes të ligjshëm për çështjen që shqyrtohet, faleminderit!

Z. K. Bele: Kemi ndonjë pyetje nga kolegët për t’ia drejtuar administratës? Me sa shoh s’ka! Kemi nevojë për pesë minuta kohë që KAS të konsultohet!

Rifillon seanca

Ora 11:05

Z. K. Bele: KAS u konsultua dhe pasi verifikoi elementët e ligjit vendosi kalimin për shqyrtim ditën e martë, datë 6 Prill 2021 ora 11:00. Seanca deklarohet e mbyllur.

Vendimi nr.18